ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 31/17
Data/Datum. 27.01.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **Komuna Kaçanik – Zyra e Prokurimit**

Për: Aktivitetin e Prokurimit: **KA-652-16-112-221**

Sa i përket tenderit për **"Mirëmbajtja e rrugëve gjatë sezonit veror dhe dimëror në komunën e Kaçanikut"**

A N K E S Ë

1. Identifikimi i ankuesit*

"EL-BAU" Sh.p.k.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Nato 99 (Rr. Tranzit drejtimi i magjistrales Gjilan – Ferziaj)
(Adresa)

Gjilan — *(Vendi)*
60 000 — *(Kodi postar)*

044 244-330 — *(Numri Telefonit)*
(Numri i Faks-it)

Suad Pireva
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
elbau_gjilan@hotmail.com
(Adresa elektronike)

Brenda afatit ligjor 27.01.2017
(Data e parashtrimit të ankesës)
(Nënshkrimi dhe vula)

NDËRMARJA PRODHUESE TËRËSISHT ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR EL-BAU LIMITED LIABILITY COMPANY GJILAN

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës e parashtron ankesën vet përmes përfaqësuesit të kompanisë "El-Bau"Sh.p.k.

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Procedura e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit Nr,prokurimi KA-652-16-069-221, me titull:"*Mirëmbajtja e rrugëve gjatë sezonit veror dhe dimrorë në Komunën e Kaçanikut*" është udhëhequr si vijon:

- *Data e publikimit te njoftimit për Kontratës 28.12.2016 publikuar ne ueb faqen e KRPP-së*
- *Afati i fundit per dorezimin e ofertave ka qene 06.01.2017, Komuna e Kaçanikut*
- *Procesi per hapjen e tendereve nga perberja e komisionit te AK-se ne prezencen e perfaqesuesve te OE pjesemarres ka filluar me date 06/01/2017 ora 14:30, Zyra e Prokurimit Komuna e Kaçanikut*
- *Kriteret per dhenien e Kontrates:* ***Çmimi me i Ulet***
- *Njoftimi për Dhënie të Kontratës OE"GrandConstruksion&Via&Eurocos" Sh.p.k në vlerë 68,565.00€ që është publikuar në ueb faqen e KRPP-së me datë 12.01.2017*

OE "El-Bau&Vemor" para zgjidhjes preliminare të mosmarrëveshjeve siç është përcaktuar me nenin 108/A të LPP-së dhe nenit 4 – b) të Rregullave për paraqitje të kërkesave për rishqyrtim pranë AK, për shkak të ngjarjes të shkaktuar nga forca madhore (bllokimi i rrugëve në Komunën e Kaçanikut dhe bllokimi i rrugës magjistrale Kaçanik – Hani i Elezit nga reshjet e mëdha të borës) dhe si pasojë e mosveprimit apo veprimit me vonesë të organit publik – Komunës së Kaçanikut apo organeve qendrore për shmangien e shkaktimit të dëmit të interesit publik dhe të drejtave dhe interesave juridike të personave, pa fajin tonë nga këto shkaqe jemi penguar për respektimin e afatit procedural – arritjen në kohën e caktuar ora 14:00 për dorëzimin e tenderëve pasi jemi jashtë afatit 10 min që i bie se kemi arritë në ora 14:10 përfaqësuesja jonë ka qenë në Zyret pritese, kati përdhesë, Komuna e Kaçanikut siç shënon në dosjen e tenderit) dhe duke vepruar sipas kërkesës së zyrtarës në fjalë përfaqësuesja e parashtruesit të ankesës dosjen e tenderit (origjinalin dhe dy kopje) i ka dorëzuar te Menagjeri i Prokurimit z. Shefket Koxha në Zyrën e Prokurimit , Kati i tretë , Komuna e Kaçanikut.Gjatë hapjes së tenderëve oferta e OE "El-Bau" edhe përkundër faktit se është pranuar nga menagjeri i prokurimit z. Koxha nuk është hapur dhe regjistruar në procesverbal të hapjes së tenderëve mirëpo në procesverbalin e tenderëve janë dorëzuar vetëm ofertat e OE "Murseli Com" me çmim 76.235.00€ dhe oferta e OE "GrandConstruksion&Via&Eurocos" Sh.p.k me çmim 68,565.00€ ndërkaq në procesverbal të hapjes në vërejtje është shënuar: "*EL BAU SHPK-VEMOR nuk është hapur sepse është dorzuar pas afatit saktësisht në ora 14:20*".

Për këtë arsye duke u bazuar në gjendjen faktike e cila është argumentuar me prova konkrete provuese dhe për të cilat është vënë në njohuri menagjeri i prokurimit z. Koxha përkundër që i njejti sipas përkujdesjes së detyrës zyrtare ka qenë në njohuri për bllokimin e rrugëve nga bora e madhe në Komunën e Kaçanikut dhe rrugës magjistrale Kaçanik-Hani i Elezit (*bazuar në informatat e bëra publike duke u thirrur në* ***rastet e***

emergjencës ekstreme ka zhvilluar procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës siç përcaktohet në nenin 35 paragrafi 2.1 (iii) të LPP-së duke ftuar dhe përzgjedhur njërën nga këto dy kompani pjesëmarrëse, OE "Murseli Com), i njejti për motive të hakmarrjes ndaj OE "El-Bau" dhe konsiderojmë sipas bindjes së tij se para vetes e ka një mundësi ideale të cilën e kishte dëshiruar e pritur qysh nga fillimi i inicimit të kësaj lënde të prokurimit (07.07.2016) që e kishte qëllim për ta **RI-SHPËRBLYER** me kontratë OE "**GrandConstruksion**&Via&Eurocos" (shih Vendimin PSH NR.431/16) dhe me qëllim të përjashtimit nga konkurenca OE "El-Bau" nuk ka lejuar komisionin që ta bëjë hapjen e ofertës tonë, andaj për këto shkaqe bazuar në ngjarjen faktike të dt.06.01.2017 të shkaktuar nga forca madhore dhe bazuar në afatet e veprimeve procedurale për palët, përcaktimi i shtyrjes e afateve procedurale të përcaktuar në Ligjin e Procedurës Administrative, përmes parashtresave me shkrim drejtuar KRPP-së dhe menagjerit të prokurimit dhe kryetarit të komunës të AK-së K. Kaçanik kemi kërkuar:

- Me datën 06.01.2017 në ora 14:59 përmes shkresës në formë elektronike lidhur me rastin e kemi njoftuar KRPP-së dhe kryetarin e saj z. Safet Hoxha nga të cilët kemi kërkuar duke bazuar në autorizimet dhe funksionin që e kanë në mbikqyrjen e përgjithshme të sistemit të prokurimit të kërkojnë nga menagjeri i prokurimit të K. Kaçanik që të pranohet për vlerësim oferta e OE "El-Bau".
  Gjithashtu KRPP-së dhe kryetarit të saj z. Hoxha ju kemi drejtuar me një shkresë edhe me datën 10.01.2017 përmes të cilës lidhur me ngjarjen e shkaktuar nga forca madhore (bora e madhe) ju kemi vënë në pah ligjet (Ligji për Mbrojtjen e Fatkeqësive Natyrore dhe fatkeqësive tjera dhe Ligji i Procedurës Administrative) që parashohin dhe përcaktojnë të drejtat që mund t'i shfrytëzojë pala që jo për fajin e vet mirëpo nga forca madhore pengohet në respektimin e një afati procedural e po ashtu për ngjarjen në fjalë ju kemi bashkangjit prova materiale (raportime të mediave, deklarata të kryetarit të komunës z. Besim Ilazi, fotografi nga vendi i ngjarjes) përmes të cilave dëshmohet se me datën 06.01.2017 rrugët në Komunën e Kaçanikut dhe rruga magjistrale Kaçanik-Hani i Elezit si pasojë e borës së madhe ka mbetur tërësisht e bllokuar dhe në këtë aks rrugor janë shkaktuar kolona të gjata dhe në vendin e ngjarjes kanë dal njësitet e Policisë së Kosovës.

- Me datën 10.01.2017 në ora 09:56 përmes emailit në drejtim të kryetarit të komunës z. Besim Ilazi dhe menagjerit të prokurimit kemi adresuar një Kerkese për pranimin dhe vlerësimin e ofertës së OE "El-Bau" lidhur me aktivitetin e prokurimit Nr.KA-652-16-112-221 me titull: *Mirëmbajtja e rrugëve gjatë sezonit veror dhe dimrorë në Komunën e Kaçanikut.* Kërkesës i kemi bashkangjit prova materiale (raportime të mediave, deklarata të kryetarit të komunës z. Besim Ilazi, fotografi nga vendi i ngjarjes) përmes të cilave dëshmohet se me datën 06.01.2017 rrugët në Komunën e Kaçanikut dhe rruga magjistrale Kaçanik-Hani i Elezit si pasojë e borës së madhe ka mbetur tërësisht e bllokuar dhe në këtë aks rrugor janë shkaktuar kolona të gjata. Një parashtresë plotësuese lidhur me kërkesën e dt. 10.01.2017 duke iu referuar edhe bazës ligjore të ligjeve përkatëse Ligjit të Procedurës Administrative i cili rregullon dhe përcakton se çfarë mund të kërkojë pala në rastet kur pengohet nga **forca madhore** për respektimin e një afati procedural.
- Me datën 17.01.2017 në ora 14:43 përmes emailit zyrtar të AK-së kacanik.prokurimi@rks-gov.net në emailin e OE "El-Bau" ka ardhur një dokument në attach i titulluar "Njoftim" që për nga përmbajtja ngjason të bëjë me kërkesën për vlerësim të ofertës së OE "El-Bau" të bërë me datë 10.01.2017 dhe 13.01.2017;

- Me datën 18.01.2017 përmes komunikimit elektronik (email) AK-K. Kaçanikut i kemi kthyer përgjigjen ne shkresën e titulluar "Njoftim" me Nr. 01-370-1625/17 e datës 17.01.2017 ndërsa AK- K. Kaçanik përmes emailit na shkruan "Keni marrë pergjigjen me shkrim dhe ate me nr. Prot. 01-370-1625/17 të dt. 17.01.2017"

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [X] **Jo** [ ]

Siç kemi theksuar më lartë për shkak se rrugët në Komunën e Kaçanikut dhe aksi rrugor i magjistralës për në Kaçanik ishin të bllokuara nga reshjet e mëdha të borës si pasojë e ngjarjes se shkaktuar nga forca madhore natyrore gjë që jo për fajin tonë ka qenë pengesë për respektimin e afatit procedural – arritjen në kohën e caktuar ora 14:00 dhe vonesa ka çenë vetëm 10 minuta që i bie se në ora 14:10 përfaqësuesja e OE "El-Bau" ka qenë në Zyret pritese, kati përdhesë, Komuna e Kaçanikut siç shënon në dosjen e tenderit) mirëpo sipas rekomandimit të zyrtarës në fjalë ka shkuar në zyrën e Menagjerit të Prokurimit e cila ndodhet në Katin e tretë ku dosja e tenderit (origjinali dhe dy kopje) i janë dorëzuar/pranuar Menagjeri i Prokurimit z. Shefket Koxha.

Përfaqësueja e OE "EL-BAU" ka marrë pjesë në procesin e hapjes së tenderëve e cila është bërë nga komisioni i hapjes së tendërëve **ku prezent ishte edhe zyrtari përgjegjës i prokurimit z. Shefqet Koxha** dhe nga komisioni i hapjes janë hapur dhe regjistruar në procesverbal të hapjes së tenderëve vetëm ofertat e OE "Murseli Com" me çmim 76.235.00€ dhe oferta e OE "GrandConstruksion&Via&Eurocos" Sh.p.k me çmim 68,565.00€ ndërkaq oferta e konzorciumit OE "EL-BAU&VEMOR" edhe përkundër faktit se ishte pranuar (origjinali dhe dy kopjet) nga menagjeri i prokurimit z. Koxha nuk është hapur dhe regjistruar në procesverbal të hapjes fare, ndërsa pasi kemi pranuar procesverbalin kemi vërejtur se në të është shënuar: *"EL BAU SHPK-VEMOR nuk është hapur sepse është dorzuar pas afatit saktësisht në ora 14:20".*

<u>Në këtë drejtim dëshirojmë të potencojmë se gjatë hapjes së tenderëve nuk ka çenë prezent askush në përfaqësim të OE "Murseli Com" dhe OE "GrandConstruction&Via&Eurokos që për ne paraqet indikacion dyshimit se nga kush dhe kur u dorëzuan ofertat e këtyre OE!!!</u>

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [ ] **Jo** [X]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] **Jo** [ ]

Bazuar në nenin 108A të LPA-së, nenit 4 dhe 5 të Rregullave për parashtrim të ankesave – FO3, në cilësi të "palës së interesuar" siç parashikohet me këtë ligj ngase në këtë aktivitet prokurimikemi marrë pjesë nga inicimi fillestar 07.07.2016 deri në Ritenderimin dytë të dt. 28.12.2016, brenda afatit ligjor me datën 16.01.2017 për shkak të rrethanave faktike të përshkruara si më lartë si dhe kundër vendimit Njoftimit për Dhënie të Kontratës OE"GrandConstruksion&Via&Eurocos" Sh.p.k në vlerë 68,565.00€ për të cilin kemi mësuar nga publikimi në ueb faqen e KRPP-së me datë 16.01.2017, kemi parashtruar Kërkesën për Rishqyrtim tek AK K. Kaçanik e cila ka udhëhequr me këtë aktivitet të prokurimit dhe të njejtën përmes formës elektronike e kemi dërguar në emailin zyrtar kacanik.prokurimi@rks-gov.net dhe adresën elektronike të kryetarit të komunës besim.q.ilazi@rks-gov.net

Provë: Kërkesa për Rishqyrtim nga OE "El-Bau" dt. 16.01.2017

Lidhur me Kërkesën për Rishqyrtim të dt. 16.01.2017 të dërguar në adresën zyrtare të AK-K. Kaçanik, nga AK,respektivisht zyrtari përgjegjës i prokurimit kemi mosveprim, heshtje të plotë –mos nxjerrje të aktit për shqyrtimin e pretendimeve ankimore të kërkesës siç e obligon neni 6 par.1 dhe par.3 i Rregullorës për parashtrim të ankesave –FO3 dhe nenit 108/A (Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve) par.6 të LPP-së. Gjithashtu nuk kemi asnjë njoftim nga AK lidhur me pezullimin apo jo të procedurës së prokurimit në fjalë.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Konsiderojmë se gjatë udhëheqjes së procedurës së prokurimit në këtë lëndë që nga momenti i pranimit/dorëzimit të ofertave, përjashtimit nga vlerësimi të ofertës së OE "El-Bau", ciklit të vlerësimit të ofertave që si rezultat është nxjerrë vendimi – Njoftimi për Dhënie të Kontratës OE"GrandConstruksion&Via&Eurocos" Sh.p.k në vlerë 68,565.00€ për të cilën kemi kuptuar nga publikimi në ueb faqen e KRPP-së me datë 12.01.2017, mosveprimit, heshtjes të plotë –mos nxjerrje të aktit – VENDIMIT lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të kërkesës siç e obligon neni 6 par.1 dhe par.3 i Rregullorës për parashtrim të ankesave –FO3 dhe nenit 108/A (Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve) par.6 të LPP-së, ngritjes të dyshimit për favorizim të kompanive të caktuara (Murseli Com dhe Grand Construction me pronarë babë e bir) vlerësojmë se gjatë këtij procesi të prokurimit nga zyrtari përgjegjës i prokurimit janë shkelur shtyllat bazike mbi të cilat bazohet prokurimi: TRANSPARENCA, EFIKASITETI&EFEKTIVITETI dhe KONKURENCA në bazë të cilave nënkupton se nuk janë aplikuar drejt (janë shkelur) dispozitat ligjore nga ligji ligjet materiale/procedurale dhe ligjet tjera si në vijim:

Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, nga i cili ligj konsiderojmë se janë shkelur dispozitat:

1. Neni 1 (Qëllimi) par. 1,2 dhe 3 i LPP-së;
2. Neni 6 (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti) par.1 i LPP-së,
3. Neni 7 (Barazia në Trajtim/ Jo Diskriminim) par. 1,2 dhe 4 i LPP-së;
4. Neni 9 (Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur) par. 1 pika (ii) i LPP-së
5. Neni 23 (Zyrtarët e Prokurimit) par. 4 i LPP-së;
6. Neni 56 (Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave) par. 1.1 dhe 1.2 i LPP-së,
7. Neni 58 (Hapja e Tenderëve) par. 2 i LPP-së
8. Neni 59 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve) par. 4 LPP-së;
9. Neni 60 (Kriteret per dhenien e kontrates) par 1.1 i LPP-së;
10. Nenin 130 (Ndikimi i Paligjshëm) par. 1 nënpar. 1.1, 12.2,1.3 dhe 1.6 i LPP-së

Aktet nënligjore nga legjislacioni sekondar që plotësojnë dhe sqarojnë dispozitat e lartshënuara të LPP-së dispozitat e lartshënuara të LPP-së:

- **Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik** që plotësojnë dhe sqarojnë dispozitat e potencuara më lartë të Ligjit të Konsoliduar Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës

- **Kodin Etik të Prokurimit** dhe atë:
  - Nenin 4 paragrafi.1 – Deklarata e interesit;
  - Neni 6 paragrafi 1 – Përkushtimi për standardet më të larta morale
  - Neni 7 paragrafi 1,2 dhe 3 – Marrëdhëniet me operatorët ekonomik, dhe
  - Pjesa C1: Deklarata nën betim për zyrtarët e prokurimit

Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën Administrative, nga i cili ligj konsiderojmë se është shkelur neni 79 paragrafi 1, 3 dhe 4.

Ligjit Nr. 02/L-068 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe nga Fatkeqësitë tjera

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Historiku procedural (tenderimi fillestar dhe dy here Ri-tenderimi) lidhur me lëndën e prokurimit Mirëmbajtja e rrugëve gjatë sezonit veror dhe dimëror në komunën e Kaçanikut."

1. OE "EL-BAU" Sh.p.k. në cilësi të palës së interesuar lidhur me këtë aktivitet prokurimi ka dorëzuar tender për këtë lëndë prokurimi që nga inicimi fillestar i këtij aktiviteti i cili është publikuar në ueb faqen e KRPP me datën 07.07.2016 e dy herë radhaz gjatë ritenderimit, ritenderimi i datës 10.10.2016 që ka ndodhur si pasojë e anulimit (përfundimit) të aktivitetit të prokurimit nga AK me datën 18.08.2016 dhe ritenderimi i fundit i datës 28.12.2016 që ka ndodhur bazuar në Vendimin PSH NR.431/16 të Panelit Shqyrtues të OSHP-së duke vendosur lidhur me ankesën e OE "EL-BAU" e cila është aprovuar pjesërisht si e bazuar dhe është anuluar vendimi i AK-së për dhënien e kontratës OE "Grand Construksion&Via&Eurocos".

2. Lidhur me Ritenderimin e fundit të datës 28.12.2016 me numër prokurimi KA-652-16-112-221 sipas kërkesës së OE "EL-BAU" me datën 29.12.2016 nga AK kemi pranuar Dosjen e Tenderit si dhe paramasën dhe parallogarinë e puneve ndërsa me datën 30.12.2016 përmes emailit na është dërguar paramasa e përmirësuar me 21 pozicione në bazë të cilës jemi udhëzuar të ofertojmë. Bazuar në Njoftimin për Kontratë të publikuar në KRPP me datën 28.12.2016 dhe Dosjen e Tenderit të datës 23.12.2016, afati i fundit për dorëzimin e tenderëve është përcaktuar data 06.01.2017 në ora 14:00 **vendi: Zyret pritese, kati përdhesë, Komuna e Kaçanikut** ndërsa takimi për hapjen e tenderëve në ora 14:30 ***vendi:*** **Zyra e Prokurimit , Kati i tretë , Komuna e Kaçanikut.**

Përshkrimi i rrethanave faktike të argumentuara me prova material bllokimin e rrugës me dt. 06.01.2017 nga drejtimi i Ferizajit rreth 2Km para se me arritë te hyrja -udhëkryqi për Kaçanik

3. Me datën 06.01.2017 gjatë udhëtimit për në drejtim të Kaçanikut për ta dorëzuar dosjen e tenderit lidhur me aktivitetin ne fjalë, në hyrje të Komunës së Kaçanikut (magjistralja Kaçanik – Hani i Elezit) diku afërsisht 2Km para se me arritë te udhëkryqi ku ndahet Rruga për Kaçanik rreth orës 13:00 kemi hasur në pengesë – bllokim të rrugës (kolnë e gjatë e automjeteve) si pasojë e reshjeve të mëdha të borës të shkaktuar nga forca madhore dhe si pasojë e mosveprimit apo veprimit me vonesë të organit publik – Komunës së Kaçanikut apo organeve qendrore për shmangien e shkaktimit të dëmit të interesit publik dhe të drejtave dhe interesave juridike të personave për zhbllokimin e rrugës, shkaqe këto të cilat pa fajin tonë (pasi ne veq në ora 13:00 ishim afërsisht 2Km në hyrje të Kaçanikut) jo për fajin tonë kanë qenë pengesë për respektimin e afatit procedural – arritjen në kohën e caktuar ora 14:00 dhe vonesa ka çenë vetëm 10 minuta (si rezultat i ecjes në këmbë pasi me veturë ka qenë e pamundur të qarkullohet) që i bie se në ora 14:10 përfaqësuesja e OE "El-Bau" ka qenë në Zyret pritese, kati përdhesë, Komuna e Kaçanikut siç shënon në dosjen e tenderit) mirëpo sipas rekomandimit të zyrtarës në fjalë ka shkuar në zyrën e Menagjerit të Prokurimit e cila ndodhet në Katin e tretë ku dosja e tenderit (origjinali dhe dy kopje) i janë dorëzuar/pranuar Menagjeri i Prokurimit z. Shefket Koxha.

4. Përfaqësueja e OE "EL-BAU" ka marrë pjesë në procesin e hapjes së tenderëve e cila është bërë nga komisioni i hapjes së tendërëve ku prezent ishte edhe zyrtari përgjegjës i prokurimit z. Shefqet Koxha dhe nga komisioni i hapjes janë hapur dhe regjistruar në procesverbal të hapjes së tenderëve vetëm ofertat e OE "Murseli Com" me çmim 76.235.00€ dhe oferta e OE "GrandConstruksion&Via&Eurocos" Sh.p.k me çmim

68,565.00€ ndërkaq oferta e konzorciumit OE "EL-BAU&VEMOR" edhe përkundër faktit se ishte pranuar (origjinali dhe dy kopjet) nga menagjeri i prokurimit z. Koxha nuk është hapur dhe regjistruar në procesverbal të hapjes fare, ndërsa pasi kemi pranuar procesverbalin kemi vërejtur se në të është shënuar: *"EL BAU SHPK-VEMOR nuk është hapur sepse është dorzuar pas afatit saktësisht në ora 14:20".*

5. Andaj për këto shkaqe bazuar në rrethanat që kanë shkaktuar ngjarjen faktike të dt.06.01.2017 të shkaktuar nga forca madhore dhe bazuar në afatet e veprimeve procedurale për palët, përcaktimi i shtyrjes e afateve procedurale të përcaktuar në Ligjin e Procedurës Administrative, përmes parashtresave me shkrim drejtuar KRPP-së dhe menagjerit të prokurimit dhe kryetarit të komunës të AK-së K. Kaçanik kemi kërkuar:
6. Përmes shkresës në formë elektronike të dt. 06.01.2017 ora 14:59 lidhur me rastin e kemi njoftuar KRPP-së dhe kryetarin e saj z. Safet Hoxha nga të cilët kemi kërkuar duke bazuar në autorizimet dhe funksionin që e kanë në mbikqyrjen e përgjithshme të sistemit të prokurimit të kërkojnë nga menagjeri i prokurimit të K. Kaçanik që të pranohet për vlerësim oferta e OE "El-Bau".

Provë: Kërkesa elektronike e dt. 06.01.2017 për KRPP

7. Përmes shkresës në formë elektronike të dt.10.01.2017 adresuar KRPP-së dhe kryetarit të saj z. Hoxha, lidhur me ngjarjen e shkaktuar nga forca madhore (bora e madhe) ju kemi vënë në pah ligjet (Ligji për Mbrojtjen e Fatkeqësive Natyrore dhe fatkeqësive tjera dhe Ligji i Procedurës Administrative) që parashohin dhe përcaktojnë të drejtat që mund t'i shfrytëzojë pala që jo për fajin e vet mirëpo nga forca madhore pengohet në respektimin e një afati procedural e po ashtu për ngjarjen në fjalë ju kemi bashkangjit prova materiale (raportime të mediave, deklarata të kryetarit të komunës z. Besim Ilazi, fotografi nga vendi i ngjarjes) përmes të cilave dëshmohet se me datën 06.01.2017 rrugët në Komunën e Kaçanikut dhe rruga magjistrale Kaçanik-Hani i Elezit si pasojë e borës së madhe ka mbetur tërësisht e bllokuar dhe në këtë aks rrugor janë shkaktuar kolona të gjata dhe në vendin e ngjarjes kanë dal njësitet e Policisë së Kosovës.

8. Përmes shkresës në formë elektronike të dt.10.01.2017 adresuar në drejtim të kryetarit të komunës z. Besim Ilazi dhe menagjerit të prokurimit kemi kërkuar pranimin dhe vlerësimin e ofertës së OE "El-Bau" lidhur me aktivitetin e prokurimit Nr.KA-652-16-112-221 me titull: *Mirëmbajtja e rrugëve gjatë sezonit veror dhe dimrorë në Komunën e Kaçanikut.* Kërkesës i kemi bashkangjit prova materiale (raportime të mediave, deklarata të kryetarit të komunës z. Besim Ilazi, fotografi nga vendi i ngjarjes) përmes të cilave dëshmohet se me datën 06.01.2017 rrugët në Komunën e Kaçanikut dhe rruga magjistrale Kaçanik-Hani i Elezit si pasojë e borës së madhe ka mbetur tërësisht e bllokuar dhe në këtë aks rrugor janë shkaktuar kolona të gjata. Një parashtresë plotësuese e kemi dërguar edhe me datën 13.01.2017 përmes cilës AK-në kemi vënë në njohuri me bazën ligjore të ligjeve përkatëse Ligjit të Procedurës Administrative i cili rregullon dhe përcakton se çfarë mund të kërkojë pala në rastet kur pengohet nga **forca madhore** për respektimin e një afati procedural.

Provë: Kërkesa elektronike e dt. 10.01.2017 dhe 13.01.2017 për AK

9. Me datën 17.01.2017 në ora 14:43 përmes emailit zyrtar të AK-së kacanik.prokurimi@rks-gov.net në emailin e OE "El-Bau" ka ardhur një dokument në attach i titulluar "Njoftim" që për nga përmbajtja ngjason të bëjë me kërkesën për vlerësim të ofertës së OE "El-Bau" të bërë me datë 10.01.2017 dhe 13.01.2017 ngase në përmbajtjen e saj është shkruar se: *"kërkesa jonë është trajtuar conform LPP-së, se nuk ka asnjë arsye për trajtim të posaqëm oferta jonë ,se palët tjera kanë mbërri me kohë nga Ferizaji qka dëshmon se nuk ka pasur pengesa në rrugë, se pretendimet tona janë të natyrës penguese në realizimin e këtij projekti dhe ofrimin e shërbimeve të qytetarëve, se në çdo tenderim të këtij aktiviteti kemi paraqitur ankesa të pa-arsyeshme vetëm për pengimin e e AK-së për realizimin e projektit dhe pasi që jemi në sezonën dimërore komuna Kaçanik është me vise malore është e domosdoshme pastrami i rrugëve nga bora dhe funksionalizimi i rrugëve rurale për lëvizjen e lirë të qytetarëve..*
10. Në lidhje me këtë shkresë me datën 18.01.2017 përmes komunikimit elektronik (email) AK-K. Kaçanikut i kemi kthyer përgjigjen ne shkresën e titulluar "Njoftim" me Nr. 01-370-1625/17 e datës 17.01.2017 ndërsa AK- K. Kaçanik përmes emailit na shkruan "Keni marrë pergjigjen me shkrim dhe ate me nr. Prot. 01-370-1625/17 të dt. 17.01.2017"

Provë: Njoftimi Nr. 01-370-1625/17 i datës 17.01.2017 si dhe shkresat tjera

Faktet e argumentuara saktësisht me prova bindëse (të gjalla) për bllokimin e rrugës me dt. 06.01.2017 nga drejtimi i Ferizajit rreth 2Km para se me arritë te hyrja -udhëkryqi për Kaçanik

11. Me datën 06.01.2017 ora 2:37 MD në fan page zyrtare të Komunës së Kaçanikut në rrjetin social Facebook të emërtuar "**Komuna Kaçanik**" është publikuar një informatë e përcjellë me një fotografi në të cilën ndër të tjera shënohet se *kryetari i komunes z. Besim Ilazi ka bërë ftesë publike kompanive të ndryshme për ndihmë në pastrimin e rrugëve ku ftesës se tij iu janë përgjigjur dhjetë kompani vendase për pastrimin e rrugëve nga bora e që sipas tij edhe krahas angazhimit të këtyre kompanive* ***reshjet e mëdha të borës kanë bllokuar pothuajse të gjitha rrugët.*** *Gjithashtu më tej në këtë njoftim konstatohet se* ***"Komuna e Kaçanikut e ka kontraktuar një kompani për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve e cila është duke u angazhuar me tërë kapacitetet e saja, pa ndërprerë, për 24 orë."***
12. Me datën 07.01.2017 ora 2:19 MD në fan page zyrtare të Komunës së Kaçanikut në rrjetin social Facebook të emërtuar "**Komuna Kaçanik**" është publikuar një informatë e përcjellë me një fotografi në të cilën ndër të tjera shënohet se *kryetari i komunes z. Besim Ilazi falenderon të gjitha kompanitë të cilat i janë ftesës së kryetarit për ndihmën në pastrimin e rrugëve nga bora nëpër rrugët e Kaçanikut. Kompanitë me të gjithë makineritë që kanë* ***gjatë tërë ditës së djeshme, mbrëm e edhe sot kanë punuar pa u ndalur që të krijojnë kushte sa më të lehta për zhbllokimin e rrugëve***

13. Me datën 06.01.2017 në portalin INDEKSONLINE është publikuar lajmi me titull "Kosovarët që ia mësyn Shkupit mbesin të bllokuar në rrugë" mandej shënohet se: *Magjistralja, Kaçanik – Shkup ka mbetur tërësisht e bllokuar, si pasojë e borës së madhe në rrugë. Kolona të gjata të automjeteve janë krijuar në këtë aks rrugor, derisa njësitet e Policisë së Kosovës kanë dal në vendin e ngjarjes.* Së bashku me këtë shkrim janë bashkangjitur edhe një mori fotografi dhe video

http://indeksonline.net/lajmet/kosovaret-qe-ia-mesyn-shkupit-mbesin-te-

bllokuar-ne-rruge-foto-video-48046/

14. Me datën 06.01.2017 në ora 11:07 në portalin LAJMI NET është publikuar shkrimi me titull: "*Vështirësi kalimi në rrugën Kaçanik – Hani i Elezit*" janë bashkangjitur edhe foto http://lajmi.net/veshtiresi-kalimi-ne-rrugen-kacanik-hani-elezit-foto/

15. Me datën 06.01.2017 në ora 10:17 në portalin KOHA NET është publikuar lajmi me titull: "Rruga Kaçanik – Hani i Elezit e bllokuar (foto)" në të cilin është shkruar: "*Mbetet e bllokuar rruga Kaçanik – Hani i Eelezit, transmeton Koha.net. Bora,ortekët dhe acari kanë bërë që sot të jetë e bllokuar rruga nga Kaçaniku deri në Han të Elezit* http://koha.net/?id=9&l=150558

16. Me datën 06.01.2017 në edicionin qendror të lajmeve të orës 19:00 në KTV nga minuta e 20-të është raportuar se: "***Policia ka njoftuar se si pasojë e të reshurave të borës janë bllokuar rrugët Kaçanik – Hani i Eelezit dhe Pejë –Kullë – Rozhajë*** https://www.youtube.com/ëatch?v=D6yXdXn1ëqQ&list=PLdZvL5MTAKSiju7UUZrëYU4zËmun7fDFU&index=3

17. Foto të cilat i kemi bërë me datën 06.01.2017 nga pritja në kolonë në rrugën magjistrale në drejtim të Kaçanikut afërsisht 2Km para se të arrijmë te udhëkryqi - rruga ku ndahet për të hyrë në Kaçanik, përmes të cilave argumentohet bllokimi i rrugës, prezenca e njësive të policisë

Provë: në ankesë janë bashkangjit të gjitha këto prova

Shkeljet thelbësore të dispozitave të LPP-së dhe LPA-së lidhur me përshkrimin e rrethanave faktike si më lartë

18. Siç kemi konstatuar më lartë oferta e OE "El-Bau&Vemor" (origjinali dhe dy kopje) është pranuar dhe ndalur nga zyrtari përgjegjës i prokurimit z. Koxha mirëpo nuk është lejuar të hapet dhe regjistrohet në procesverbalin e hapjes së ofertave me arsyetimin se është dorëzuar me vonesë edhe përkundër faktit se përveq që ne e kishim njoftuar me prova të argumentuara me fakte i njejti në cilësi të zyrtarit përgjegjës të prokurimit kishte njohuri të plotë për bllokimin e rrugëve në Komunën e Kaçanikut dhe rrugës në hyrje të Kaçanikut nga drejtimi i Ferizajit dhe kishte pasur obligim të veprojë me kohë për shmangien e pengesave të shkaktuara nga reshjet e mëdha të borës.

Mosaplikimi i drejtë i nenit 58 par.1 i LPP-së

Në nenin 58 paragrafi 1 në fjalinë e parafundit shprehimisht thuhet: "*Afati i caktuar për hapjen publike të tenderëve duhet të jetë **menjëherë** pas afatit të fundit kohor të caktuar për pranimin e tenderëve*". Fjala (ndajfolja) menjëherë ka kuptimin në atë çast, aty për aty.

Duke pasur parasysh se ligji është akt më i lartë se aktet tjera nënligjore si dhe dosja e tenderit e cila detyrimisht duhet të jetë në harmoni me LPP dhe faktit se në këtë dispozitë thuhet se afati i caktuar për hapje publike të tendërve duhet të jetë menjëher pas afatit për pranim të tenderëve rezulton se oferta e dorëzuar nga ana e OE "El-Bau" e dorëzuar në ora 14:10 apo çoftë siç ka shënuar në procesverbal të hapjes 14:20 është dorëzuar brenda afatit të caktuar para hapjes së tendërve ora 14;30 siç përcaktohet

shprehimisht me këtë dispozitë ligjore

Mosaplikimi i drejtë i nenit 58 par.2 LPP-së dhe nenit 34.3 të RrUOPP

Në nenin 58 paragrafi 2 në fjalinë e dytë thuhet: *Tenderët që janë dorëzuar pas afatit të fundit kohor nuk do të hapen ose shqyrtohen dhe menjëherë do t'i kthehen të pahapura operatorëve ekonomik që i kanë dorëzuar ato.*

Në nenin 34.3 të RrUOPP thuhet:*"Në rast se tenderët/kërkesat për pjesëmarrje/kuotimet,dorëzohen në AK pas skadimit të afatit kohor për dorëzim, pranimi i tenderëve/kërkesave për pjesëmarrje/kuotime të tilla, do të refuzohen ose zarfet e pranuara do të mbahen të pa-hapura me qëllim të kthimit të menjëhershëm te dërguesi. Një **Regjistër i dorëzimit të tenderëve të vonuar"** do të plotësohet ngjashëm me **"regjistrin e dorëzimit të tenderëve"** të cekur në nenin 34.2 të këtyre Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ*

AK përkatësisht zyrtari përgjegjës i prokurimit z. Koxha edhe përkundër asaj që është thirrur se kemi dorëzuar tenderin me vonesë siç është shënuar me vrejtje në procesverbalin e hapjes së tenderëve në ora 14:20, i njejti nuk ka zbatuar drejt dispozitat e nenit 58.2 të LPP-së dhe 34.3 të RrUOPP për faktin se nuk e ka regjistruar tenderin në formularin e nxjerrë nga KRPP ***"Regjistër i dorëzimit të tenderëve të vonuar"*** dhe se të njëjtin (origjinal dhe dy kopje) i ka ndalur dhe nuk i ka kthyer te përfaqësuesi i OE "El-Bau"

Shkeljet thelbësore të dispozitave të LPA-së lidhur me përshkrimin e rrethanave faktike si më lartë

19. Në rastet kur një palë për arsye të justifikuara dhe jo për fajin e vet pengohet për respektimin e një afati procedural nga një forcë madhore siç kemi përshkruar rastin më lartë, sipas rregullave juridike nëse LPP nuk përmban dispozita që do të zbatohen për rastet e tilla atëher do të zbatohen dispozitat e ligjeve special që përmbajnë këto dispozita dhe përjashtojnë/plotëson ligjin e përgjithshëm (lex generals).

Mosaplikimi fare i nenit 79 të LPPA-së apo nenit 124 të LPA

Në nenin 79 (Rivendosja në afat) të LPPA në paragrafët në vijim thuhet

20. *Përpos kur ndalohet shprehimisht nga ligji, **në rastet kur për arsye të justifikuara e jo për faj të vet, një palë që është penguar për respektimin e një afati procedural, mund të kërkojë rivendosjen e afatit të humbur.***

21. *Kërkesa për rivendosjen në afat mund të parashtrohet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga largimi i pengesës, por jo më vonë se një (1) vit nga skadimi i afatit të humbur.*

22. ***Në rastin kur pala është penguar nga një forcë madhore, kërkesa për rivendosje në afat mund të parashtrohet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga largimi i pengesës, pavarësisht nga koha që ka kaluar nga skadimi i afatit të humbur.***

Në nenin 124 (Rivendosja në afat) të LPA-së në paragrafët në vijim thuhet

23. *Në ato raste kur personi fizik dhe juridik kundër të cilit zbatohet akti administrativ është penguar që të respektojë afatin kohor për zbatimin të parashikuar nga ky Ligj ose dispozita të tjera ligjore, ai person ka të drejtë të kërkojë rivendosjen e afatit të humbur, përveç rasteve kur ligji shprehimisht ndalon rivendosjen e afatit.*

24. *Kërkesa për rivendosjen e afatit duhet të bëhet brenda 10 ditëve nga dita kur janë zhdukur pengesat, por jo më shumë se një vit nga dita e fundit e afatit të humbur, përveç rasteve të një force madhore.*

AK përkatësisht zyrtari përgjegjës i prokurimit z. Koxha edhe përkundër asaj që në bazë të kërkesave të dt. 10.01.2017 dhe 13.01.2017 është njoftuar me argumente të fakjtuara me prova materiale dhe se në rastet e tilla ekziston bazë ligjore përkatëse që rregollojnë situata kur një palë pengohet për respektimin e një afati procedural si pasojë e ngjarjes së shkaktuar nga forca madhore.

Ligji Nr. 02/L-068 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe nga Fatkeqësitë tjera, në nenin 3, i titulluar Përkufizimet – Nocionet e përdorura në këtë ligj përkufizohen si vijon: pika iv., thotë: *Fatkeqësitë natyrore nënkupton tërmetet, vërshimet, **rrëshqitjet e borës, bora e madhe, era e fortë, breshri, akulli,** thatësira, paraqitja masive e sëmundjeve ngjitëse te njerëzit, te shtazët dhe te bimët dhe fatkeqësi të tjera, që i shkakton natyra.*

Shkeljet e dispozitave të LPP-së që përbëjnë shtyllat bazike mbi të cilat bazohet prokurimi që lidhen rrethanat faktike dhe shkeljet ligjore si më lartë

Administrimi i përgjithshëm të procedurave të prokurimit në këtë aktivitet prokurimi nga momenti i pranimit/dorëzimit të ofertave, përjashtimit nga vlerësimi të ofertës së OE "El-Bau", ciklit të vlerësimit të ofertave që si rezultat është nxjerrë vendimi – Njoftimi për Dhënie të Kontratës OE"GrandConstruksion&Via&Eurocos" Sh.p.k në vlerë 68,565.00€ për të cilën kemi kuptuar nga publikimi në ueb faqen e KRPP-së me datë 12.01.2017, mosveprimit, heshtjes të plotë –mos nxjerrje të aktit – VENDIMIT lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të kërkesës për rishqyrtim, favorizimit të kompanive të caktuara (Murseli Com dhe Grand Construction me pronarë babë e bir), nuk mund të shqyrtohet për nga ligjshmëria e tij për shkak shkeljeve thelbësore të dispozitave të LPP-së, shtyllave të parimeve bazike të prokurimit (transparenca, efikasiteti&efektiviteti dhe konkurrenca) dhe ligjeve tjera ngase të gjitha këto vendime në pikpmaje të gjendjes faktike janë nxjerrë në mënyrë të padrejtë dhe të paligjshme për shkak të mos-zbatimit farë dhe mos-zbatimit në mënyrë të drejtë të dispozitave të lartshënuara që kanë pasur ndikim në nxjerrjen e vendimeve të ndikuara janë të ndërlidhura me shkeljet nga dispozitat si në vijim:

25. Është shkelur neni 1, neni 6, neni 7 i LPP-së dhe parimet bazike të prokurimit nga neni 4.4 të RrUOPP, për shkak se me asnjë fakt nuk është vërtetuar se gjatë këtij prokurimi është siguruar mënyrë efikase, transparente dhe të drejtë të shfrytëizmit të fondeve publike, për arsyet e lartshënuara vendimet janë ndikura nga interest personale dhe materiale duke shkelur parime e përgjithshme të ekonomicitetit/efikasitetit dhe barazisë në trajtim/jo-diskriminim për shkak të favorizimit të dy OE të caktuar në drejtim të shpërblimit të kontratës dhe paraqitjes së pengesave të ndryshme me qëllim të eliminimit hapur të konkurencës në dëm të OE "El-Bau"

26. Është sheklur neni 59.4 dhe neni 60.1.1 për arsye se po të hynte në proces të vlerësimit oferta e OE EL-BAU do të rezultonte se ka dorëzuar tender të përgjegjshëm në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe bazuar në nenin 59.4 si dhe kriterin e tenderit të përgjegjshëm me çmim më të lirë në 59,925.00€ bazuar në nenin 60 paragrafi 1.1. të LPP-së. Për shkak se na është mohuar e drejta për qasje të barabartë në pjesëmarrje që me kontratë të shpërblehet OE *"Grand Construksion&Via&Eurocos"* që ka çmim më të lartë e përkundër kësaj dyshojmë se e ky OE ka marrëveshje të të fshehta me OE e babait të tij "Murseli Com" andaj ngrisim dyshim se vlerësimi dhe vendimi për dhënie të kontratës për këtë OE është në kundërshtim me nenin 59.4, nenin 60.1.1 dhe nenin 130 të LPP-së

Me një logjikë të thjeshtë duke analizuar diagonalen e rritjes së ofertave e OE *"Grand Construksion&Via&Eurocos"* (herën e parë 56,881.00€, herën e dytë 60,448.50€ dhe herën e tretë 68,565.00€) gjithashtu ofertat e OE Murseli Company" (herën e parë 72,804.00€, herën e dytë 73,000.00€ dhe herën e tretë 76,235.00€), pa dyshim që

mendja të shkon te marrëveshjet e fshehta dhe aranzhimet e çmimeve në mes tyre dhe syshiminin për negociata me AK me qëllim të eliminimit dhe kufizimit të konkurencës me OE tjerë.

27. Është shkelur neni 23 paragrafi 4 pika ii) dhe iii) e LPP-së lidhur me nenit 3.4 dhe 3.5, nenit 4.1 dhe 4.5, nenit 6.1, nenin 7 të Kodit Etik të Prokurimit, për arsye se gjatë gjithë fazës së kësaj lënde të prokurimit (tenderimit fillestar dhe dy ri-tenderimeve) nga zyrtari përgjegjës i prokurimit është ndërhyrë në procesin konkurues të konkurencës së drejtë dhe të barabartë në mes OE pjesëmarrës duke drejtuar dhënien e kontratës gjatë gjithë fazave te OE i parapëlqyer dhe caktuar OE"GrandConstruksion&Via&Eurocos" ndërsa në anën tjetër për shkak të trajtimit jo të barabartë dhe eliminimit të konkurencës po i dëmton ashiqare interesat afariste dhe të ligjshme të OE EL-BAU. Të gjitha këto veprime janë të sanksionuara me Kodin Etik të Prokurimit dhe se bazuar në **Pjesën C1: Deklarata nën betim për zyrtarët e prokurimit e cila është e obliguar i njejti është deklaruar nën betim se *"Sinqerisht dhe me besnikëro do ti udhëheq detyrat e vlerësimit në përputshmëri me LPP"***

28. Lidhur me Kërkesën për Rishqyrtim të dt. 16.01.2017 të dërguar në adresën zyrtare të AK- K. Kaçanik, nga AK,respektivisht zyrtari përgjegjës i prokurimit kemi mosveprim, heshtje të plotë –mos nxjerrje të aktit –VENDIMIT lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të kërkesës siç e obligon neni 6 par.1 dhe par.3 i Rregullorës për parashtrim të ankesave –FO3 dhe nenit 108/A (Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve) par.6 të LPP-së. Gjithashtu nuk kemi asnjë njoftim nga AK lidhur me pezullimin apo jo të procedurës së prokurimit në fjalë.
Andaj AK përkatësisht zyrtari përgjegjës i prokurimit ka shkelur neni 6 par.1 dhe par.3 i Rregullorës për parashtrim të ankesave –FO3 dhe nenit 108/A (Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve) par.6 të LPP-së.

Andaj duke konsideruar se me vendimin e ankimuar AK ka vepruar në kundërshtim me aplikimin e dispozitave të lartshënuara të LPP-së dhe akteve nënligjore që si pasojë nga shkeljet e pretenduara ka rezultuar me dëmtimin e konzorciumit OE "El-Bau&Vemor" kërkojmë nga OSHP të shqyrtojë ankesën në bazë të dispozitave të specifikuara në pjesën e IX-të të LPP-së, dhe pas administrimit të provave dyuke bërë vlerësimin detal të të gjitha pretendimeve ankimore dhe duke ju dhënë peshë të gjitha fakteve të paraqitura në ankesë, i propozojmë të merr këtë

VENDIM

- **MIRATOHET** si e bazuar ankesa e OE "EL-BAU" me seli në Gjilan;
- **ANULOHET** Vendimi– Njoftimi për Dhenie të Kontratës OE "Grand
- **DETYROHET** AK te merr masa adekuate korrigjuese për eliminimin e lëshimeve ligjore dhe të vendoset të shperblehet me kontrat OE "El-Bau"si ofertuesi i vetëm i pergjegjshem me çmimin më të ulët që ploteson te gjitha kriteret e kerkuara ne dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë;
- **REFUZOHET** çfarëdo kërkese e AK-së për heqjen e pezullimit të aktivitetit të prokurimi

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

OE "EL-BAU" Sh.p.k. në cilësi të "palës së interesuar" siç parashikohet me këtë ligj pretendon se është dëmtuar dhe i janë shkelur të drejtat nga vendimi i kundërligjshëm AK-së në kundërshtim me dispozitat e lartshënuara pasi që me vendimin për eliminim të OE "EL-BAU" pa u bazuar në gjendjen faktike dhe juridike iu është cënuar e drejta të shpërblehet me kontrat si ofertuesi i pergjegjshem me çmimin më të ulët.
Do të ndiqen të gjithë hapat ligjorë të ankimimit në të gjitha shkallët për të realizuar të drejtën tonë ligjore për kompenzimin e dëmit të shkaktuar nëse vendimi i njejtë mbetet në fuqi gjatë fazës së rishqyrtimit nga organi i shkallës së njejtë. Shpresojmë që organi që ka nxjerrur vendimet në fjalë gjatë rishyqrtimit të evitojë shkeljet e identifikuara nga ne të cilat janë të mbështetura në fakte dhe dëshmi materiale si dhe bazuar në to të nxjerr një vendim të saktë, të ligjshëm dhe meritor.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Ankesës i bashkangjiten ne kopje dokumentet e konstatuara me larte.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*